




REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. / Dep. / Dep.	2-D/DPK
Nr. / No. / No.	01-3905/13
Broj / Stranica / No. pages	02
Data / Datum / Date	15-11-2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 pika 11,12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.11.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3053/13, për z. Blerim Krasniqi – Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në Postën e Kosovës sh.a, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për Zyrtarin e Lartë, z. Blerim Krasniqi – Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në Postën e Kosovës sh.a, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Krasniqi është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (me datë 14.10.2013), pas së cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë. Me këtë rast ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Krasniqi, në këtë takim ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznes privat dhe do të vazhdojë të ushtroj funksionin e tij publik.

Ndërkohë, z. Krasniqi ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë(DPKI.03- 3825/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar që kishte në N.P. “E.G.B. Audit & consulting” për të ushtruar funksionin e tij publik si Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në Postën e Kosovës sh.a, me çka ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së ;
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës).

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

